



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollesha", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION:

“IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit **“Ekipe Sportive 2022”**, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës **“IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik”**

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik

IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik, nën mbikqyrjen e supervizorit përkatës, është përgjegjës përdorimin dhe funksionimin e pajisjeve të ndryshme mediatike, duke përfshirë pajisjet video, filmike, fotografike dhe audio. Objektivi i këtij pozicioni është të mbikëqyrë, të mirëmbajë ose të përdorë pajisje shumë teknike ose komplekse, të tilla si pajisjet multimediale, projektuese, kompjuterike dhe/ose aplikacione të ndryshme kompjuterike. Për të përmbushur objektivat e caktuara IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik duhet të ketë:

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar studimet e larta.
- 2-3 vite eksperiencë profesionale në fushën e IT.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në grup dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve.
- Të ketë aftësi për të realizuar lidhje direkte streaming për të mbuluar gjithashtu transmetimin në TV, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn, Youtube.
- Të mund të mirëmbajë ose të përdorë pajisje shumë teknike ose komplekse, të tilla si pajisjet multimediale, projektuese, kompjuterike dhe aplikacione të ndryshme kompjuterike.
- Të ketë njohuri specifike mbi pajisjet teknike dhe programet kompjuterike që përdoren për live streaming.
- Të zotërojë në nivel shumë të mirë "Paketën Office".
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin IT dhe Teknik Bazë për një Grup Mediatik "Ekipet Sportive 2022"**.